

Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj takime pune në GAO me : zj.St.Laurent, z.Blockwood, z. Chuck Youngdhe z.R.Muça (KLSH). Washington D.C, 5 shkurt 2020

Në dt. 05.02.2020, drejtuesit e KLSH-së, Kryetari z. Bujar Leskaj dhe Drejtori i Përgjithshëm, z. Rinald Muça, vizituan Zyrën e Llogaridhënies Qeveritare në ShBA (GAO). Qëllimi i vizitës ishte diskutimi mbi bashkëpunimin gjatë 6 viteve të fundit, me fokus vijimin e trajnimeve periodike të audituesve të KLSH-së në programin e fellowship-it amerikan, njohja me dy botimet me të fundit të KLSH-së mbi GAO-n, respektivisht "GAO, NIK dhe leksionet e Dodaros" dhe "GAO, lideri i INTOSAI-t (dokumente pune)", prezantimi tek kolegët amerikanë i punës dhe progresit të KLSH-së në auditimet e performancës, specifikisht mbi rezultatet e auditimit të performancës mbi teknologjinë 5G, çështje për të cilën drejtuesit e KLSH-së morën pjesë edhe në forumin e Cyber Security organizuar në Senat në dt. 03.02.2020.

GAO u përfaqësua në këtë takim nga z. James-Christian Blockwood, Drejtor i Planifikimit Strategjik dhe Koordinator i Jashtëm, Chuck Young, Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë, Tim Bowling, Drejtor i Garantimit të Cilësisë, Mike Hix, Drejtor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Mark Keenan dhe Brenda Fernandez, menaxhere të Programit të Fellowship-it dhe Janet St Laurent, Drejtoreshë e Qendrës së Ekselencës.

Takim i Kryetarit të KLSH-së, z.Bujar Leskaj me z. James-Christian Blockwood, Drejtor i Planifikimit Strategjik dhe Koordinator i Jashtëm, GAO, Washington D.C, 5 shkurt 2020.

Në fjalën e tij, z. Leskaj u ndal në rolin e madh që GAO dhe veçanërisht z. Gene Dodaro ka luajtur për komunitetin INTOSAI dhe specifikisht për Shqipërinë. Dy botimet që iu përcollën zyrtarisht palës amerikane ishin shprehje të mirënjohjes, vlerësimit dhe aplikimit në praktikë të motos së INTOSAI-t që KLSH dhe Shqipëria kanë ndaj partnerit tonë historik dhe strategjik. Kolegët amerikanë, pasi u njohën me përmbledhjen në anglisht të botimeve dhe veçanërisht të botimit të z. Leskaj "GAO, NIK dhe leksionet e Dodaros", falenderuan stafin e KLSH-së dhe z. Leskaj për këtë vlerësim unik, që vjen në vazhden e botimeve të vazhdueshme që KLSH ka bërë dhe do vazhdojë të bëjë për GAO-n. Më pas, z. Leskaj bëri një përmbledhje të performancës institucionale në shifra dhe fakte, duke dhënë dinamikën ndër vite.